



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.Dh.Sh.II.nr.298/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhomat e Shkallës së Dytë, me gjyqtarin individual Krenar Berisha, në çështjen juridike përmbare të kreditorit Telekom i Kosovës SH.A., me seli në Prishtinë, kundër debitorit "DELTA ING" SH.P.K., me seli në Magjistralen Prishtinë-Ferizaj km 2, Veternik, me bazë juridike përmbare pagesë e borxhit, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i Përgjithshëm, KPPP.nr.1303/2022 të datës 27.11.2023, me datë 08.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e bazuar ankesa e kreditorit Telekom i Kosovës SH.A., me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i Përgjithshëm, KPPP.nr.1303/2022 i datës 27.11.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.1303/2022 të datës 27.11.2023, ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit "DELTA ING" SH.P.K., dhe urdhrin përmbare P.nr.764/21 të datës 23.11.2021, të Përmbaresit Privat Irfan I. Kërçagu, e ka shfuqizuar.

Kundër këtij aktvendimi në afat ligjor ka ushtruar ankesë kreditori, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet si e bazuar ankesa, aktvendimi i ankimuar të priset dhe të mbetet në fuqi urdhri përmbare P.nr.764/21 i datës 23.11.2021 apo aktvendimi i ankimuar të priset dhe lënda të kthehet në rishqyrtim në gjykatën e shkallës së parë.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbare (LPP), si dhe në kuptim të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Telekom i Kosovës SH.A., me seli në Prishtinë, me datë 23.11.2021, ka paraqitur propozim për përmbaerim kundër debitorit "DELTA ING" SH.P.K., me seli në Magjistralen Prishtinë- Ferizaj km 2, Veternik, në bazë të dokumenti të besueshëm – faturës nr. 050421003968, për shumën e detyrimit prej 372.74 Euro.

Përmbaeruesi privat Irfan I. Kërçagu, duke vepruar sipas propozimit për përmbaerim të kreditorit me urdhrin P.nr.764/2021 të datës 23.11.2021, ka lejuar përmbaerimin kundër debitorit në bazë të dokumentit të besueshëm – faturës, duke vlerësuar se dokumenti i besueshëm i plotëson kushtet për përmbaerim.

Kundër këtij urdhri përmbaerimor debitori me datë 09.12.2021 ka paraqitur prapësim, duke e kundërshtuar urdhrin përmbaerimor, me arsyetimin se debitori me kohë e ka njoftuar kreditorin për ndërprerje të romingut, dhe se fatura e paraqitur nuk e specifikon se prej cilit vit rrjedh borxhi nga cili është faturuar si dhe nuk specifikohet çmimi i saktë i secilës faturë veç e veç për borxhin paraprak. Më tutje ka shtuar se për tu konsideruar një dokument i besueshëm ajo duhet patjetër të jetë e nënshkruar dhe e vulosur nga të dyja palët sidomos kur ka të bëjë me dy subjekte juridike, dhe njëkohësisht ti bashkëngjitet edhe fletë dërgesa e mallit të pranuar nga ana e debitorit sipas specifikimit të faturimit, gjë që kreditori nuk ka arritur të dëshmoj një gjë të tillë. Andaj ka propozuar që të aprovohet prapësimi dhe të shfuqizohet urdhri përmbaerimor P.nr.764/2021 i datës 23.11.2021.

Përgjigje në prapësim ka paraqitur kreditori me datë 10.12.2021, duke e kundërshtuar prapësimin e debitorit, me arsyetimin se debitori ka qenë i njoftuar me dërgimit të faturës për mes komunikimit elektronik në adresën e debitorit, këtë gjë e vërteton sipas konfirmimit nga departamenti i faturimit të kreditorit. Ka shtuar se është precizuar borxhi kryesor nga departamenti i Riskut në Telekomin e Kosovës në shumën reale të borxhit 186.18 € dhe pjesa tjetër e borxhit është korrigjuar si penaly që është ngarkuar për mos përfundimin e kontratës. Andaj ka propozuar që të hedhet poshtë prapësimi i debitorit.

Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i Përgjithshëm, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, ka nxjerrë aktvendimin KPPP.nr.1303/2022 të datës 27.11.2023, me të cilin ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit "DELTA ING" SH.P.K., dhe urdhrin përmbaerimor P.nr.764/21 të datës 23.11.2021, të Përmbaeruesit Privat Irfan I. Kërçagu e ka shfuqizuar.

Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar gjykata e shkallës së parë ka theksuar se pas vlerësimit të prapësimin, përgjigjes në prapësim dhe shkresave të lëndës, ka gjetur se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbaerimor duhet të anulohet dhe procedura përmbaerimore të përfundohet në tërësi për shkak se dokumenti – fatura me numër 050421003968, në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbaerim, nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së, për

faktin se fatura në rastin konkret është lëshuar në mënyrë të njëanshme nga ana e kreditorit dhe nuk është pranuar nga debitori, përkatësisht e njëjta nuk përmban nënshkrimin apo vulën e pranuesit – debitorit dhe nuk ka dëshmi se e njëjta është pranuar nga debitori në ndonjë mënyrë tjetër. Andaj, duke qenë se debitori nuk e ka pranuar në mënyrë të rregullt faturën, si të tillë e njëjta nuk mund të shërbej si dokument i besueshëm dhe nuk ka tipare të përmbarueshmërisë.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë, e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë, në bazë të nenit 194 të LPK-së, i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbarimore me rastin e vendosjes për aprovim të prapësimit të debitorit. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, Dhomat e Shkallës së Parë drejtë ka vlerësuar gjendjen faktike kur ka konstatuar se fatura nr.050421003968, në shumë prej 372.74 Euro, e lëshuar nga ana e kreditorit nuk përmban nënshkrim dhe as vulën nga debitori. Në këtë drejtim gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar dispozitat ligjore të nenit 29 paragrafi 1, pika 1.1 të LPP-së, i cili përcakton se: *Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokument i besueshëm, sipas këtij ligji është: 1.1. kambialet dhe çeket me potest dhe **faturë kthyese**, po që se janë të nevojshme për themelimin e kërkesës*, kurse me paragrafin 3 të të njëjtit nen përcaktohet se: *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*.

Mbi bazën e këtyre dispozitave ligjore, kjo gjykatë vlerëson se Dhomat e Shkallës së Parë ka konstatuar drejtë se fatura nr.050421003968, në shumë prej 372.74 Euro, si dokument i besueshëm mbi të cilën është iniciuar procedura përmbarimore, respektivisht është lejuar përmbarimi nuk i plotëson kushtet në mënyrë kumulative që duhet t’i ketë dokumenti i besueshëm. Në rastin konkret qartë rezulton se fatura kontestuese nuk e përmban nënshkrimin e pranuesit e as vulën e pranuesit i cili është kusht esencial që duket ta ketë njërën nga këto e mbi bazën e së cilës dokumenti i besueshëm fiton tipare të përmbarueshmërisë së titullit ekzekutiv, mbi bazën e së cilës mund të konstatohet ekzistimi i detyrimit dhe pranimi si i tillë nga debitori. Që nënkupton se pa plotësimin e këtij kushti dokumenti i besueshëm nuk mund ta ketë fuqinë e titullit përmbarues sepse rezulton se debitori nuk e ka pranuar detyrimin, prandaj edhe dokumentet e besueshme në raport me dokumentet tjera përmbarimore duhet ta kenë fuqinë e pa kontestuar ekzekutive në mënyrë që procedura përmbarimore të iniciohet përmes këtyre dokumenteve.

Së këndejmi, edhe gjykata e shkallës së dytë është e qëndrimit të njëjtë juridik se në procedurën përmbartimore organi përmbartues, përfshirë këtu edhe gjykatën që ka kompetencë shqyrtimin e ligjshmërisë së përmbartimit, nuk ka tagër të vlerësojë ligjshmërinë e raportit juridik nga i cili rrjedh dokumenti i besueshëm, statusin e palëve apo detyrimet e ndërsjella mes tyre. Organi përmbartues, përfshirë edhe gjykatën e shkallës së parë shqyrton vetëm rregullsinë dhe përshtatshmërinë e dokumentit përmbartues dhe/apo atij të besueshëm, me ç'rast procedura sipas prapësimit i nënshtrohet vetëm shqyrtimit formal të titullit ekzekutiv.

Gjykata ankimore ka shqyrtuar pretendimet ankimore të kreditorit lidhur me atë se debitori ka pranuar faturën kontestuese, mirëpo të njëjtat kjo gjykatë i vlerëson si të pabazuara dhe të paprovuara me provat, për faktin se nga shkresat e lëndës nuk rezulton të ketë asnjë provë që vërteton se debitori ka pranuar faturën kontestuese dhe vlerën e borxhit të kërkuar nga kreditori përmes kësaj fature.

Andaj, duke marr parasysh pretendimet ankimore të palës ankuese, të cilat konsistojnë ndaj aktvendimit të ankimuar, Gjykata Komerciale - Dhomat e Shkallës së Dytë konsideron se këto pretendimet ankimore janë të pa bazuara, ngase nuk kemi të bëjmë me shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore, dhe zbatimin të gabuar të drejtës materiale, të cilat shkelje kjo gjykatë i vështron sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, dhe as të Ligjit të Procedurës Përmbartimore.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 209 pika b) të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Dytë
K.Dh.Sh.II.nr.298/24 me datë 08.05.2024

Gjyqtari,
Krenar Berisha